



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONIERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 8.3.2023

Nr: 124

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “ALEANCA DEMOKRISTIANE E SHQIPËRISË”,
PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE
TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 8.3.2023, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 423 prot., datë 26.1.2023, me:

Kërkues: Partia politike “Aleanca Demokristane e Shqipërisë”, me kryetar z. Zef Bushati

Objekti: Regjistrimi i partisë politike “Aleanca Demokristane e Shqipërisë” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023

Baza ligjore: Neni 64 i ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

Në përfundim të shqyrtimit administrativ

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, me dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Partia “Aleanca Demokristane e Shqipërisë”, nëpërmjet kryetarit të saj z. Zef Bushati, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen më datë 14 maj 2023, administruar.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 25.1.2023, nëpërmjet të cilit vërtetohet se partia “Aleanca Demokristane e

Data: 8.3.2023 Nr: 124
Ora:11:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Aleanca Demokristane e Shqipërisë” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

Shqipërisë”, me iniciale “ADK”, me kryetar z. Zef Bushati rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj zyre;

- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike, (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është partia “Aleanca Demokristane e Shqipërisë” me shkronja nistore “ADK”, me adresë rruga “Karl Gega”, P.24/2/3,Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është z. Zef Bushati, me adresë, rruga “Osman Myderrizi”, pallati Lura, shk.2, ap.18,Tiranë 2-1060;
- c) Financieri i partisë është znj. Sidorela Vasku, me adresë, rruga “Osman Myderrizi”, pallati 1, kulla 2, nr.19, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është znj. Domenika Gjeçi dhe z. Pjetër Deda, me adresë, rruga “Osman Myderrizi”, pallati 1, kulla 2, nr.19, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga partia “Aleanca Demokristane e Shqipërisë”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1, të nenit 64, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues kërkesës, i paraqitur nga partia “Aleanca Demokristane e Shqipërisë”, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2, dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, nenin 64, pika 2, dhe nenin 92 /2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të udhëzimit nr.1, datë 18.1.2023, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”

VENDOSA:

Data: 8.3.2023 Nr: 124
Ora:11:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Aleanca Demokristiane e Shqipërisë” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

1. Regjistrimin e partisë politike “Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”, me kryetar z. Zef Bushati, me shkronja nistore “ADK”, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI